

Zotërimi Doktrinor për Librin e Mormonit: Vlerësimi 2

ALMA - MORONI

Referencat e zotërimit doktrinor

Për pyetjet 1–3, shkruaj shkronjën e referencës përkatëse në vendin bosh pranë çdo fraze. Të lutem, mos i përdor shkrimet e tua të shenjta për këtë pjesë të vlerësimit.

Frazat Kyç	Referencat nga Shkrimet e Shenjta
_____ 1. "Dashuria hyjnore është dashuria e pastër e Krishtit."	a. Alma 39:9 b. Alma 41:10
_____ 2. "Dhe ai do të shkojë përpara, duke vuajtur dhimbje dhe hidhërimë dhe tundime të çdo lloji."	c. Moroni 7:45–48 d. Helamani 5:12
_____ 3. "Mos shko më pas epsheve të syve të tua."	e. Alma 7:11–13

Frazat kyç të shkrimit të shenjtë

Për pyetjet 4–6, plotëso fjalët që mungojnë në frazat kyç të shkrimit të shenjtë për zotërimin doktrinor. Të lutem, mos i përdor shkrimet e tua të shenjta për këtë pjesë të vlerësimit.

4. "Kërkoni me një zemër _____, me _____ të vërtetë duke pasur besim në Krisht. . . . Dhe nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, ju mund të _____ të vërtetën e të gjitha gjërave." (Moroni 10:4–5)
5. "Është mbi _____ e _____ tonë . . . që ju duhet të ndërtoni _____ tuaj." (Helamani 5:12)
6. "Ju nuk do të merrni asnjë _____, deri pas _____ së _____ tuaj." (Ethëri 12:6)

Zbatimi në situatat nga jeta reale

Mund t'i përdorësh shkrimet e tua të shenjta për pjesën e mbetur të vlerësimit.

Për pyetjet 7–9, përcakto një ose më shumë fragmente të zotërimit doktrinor nga Alma deri te Moroni, që mund ta ndihmojnë dikë në situatat vijuese. Shpjegoje përse e përzgjedhe atë fragment/e.

7. Një e re që po mëson rreth Kishës, dëshiron të dijë se çfarë duhet të bëjë për ta ndjekur Jezu Krishtin.

8. Shoku yt nuk e kupton rëndësinë e Jezu Krishtit dhe të pyet se çfarë ka bërë Ai për ne.

9. Një i ri dëshiron të dijë se si mund ta marrë ndihmën dhe forcën e Perëndisë për t'u mbrojtur nga tundimet e Satanit.

Parimet e marrjes së njohurisë shpirtërore

Për pyetjet 10–11, demonstro njohurinë dhe aftësinë tënde për t'i përdorur parimet e marrjes së njohurisë shpirtërore.

10. Si do t'ia shpjegosh dikujt parimet vijuese të marrjes së njohurisë shpirtërore?

a. Vepro me besim.

b. Shqyrtoji konceptet dhe pyetjet me një këndvështrim të përvetshëm.

c. Kërko kuptueshmëri të mëtejshme nëpërmjet burimeve të caktuara në mënyrë hyjnore.

11. Ndonjëherë një e re ndien sikur urdhërimet e Perëndisë janë tepër kufizuese. Ajo pyet veten a do të ishte më e lumtur nëse do të mund ta jetonte jetën e saj në cilëndo mënyrë që ajo e ndien se është më e mira.

Përgjigju për pyetjet vijuese:

a. Çfarë gjërash të veçanta mund të bëjë ky person për të vepruar me besim?

b. Si mund ta ndihmojë atë të parit e kësaj situatë me një këndvështrim të përvetshëm?

- c. Fragmentet e zotërimit doktrinor janë shembuj të burimeve të caktuara në mënyrë hyjnore. Cili fragment/e i zotërimit doktrinor mund të jetë i dobishëm në këtë situatë? Në ç'mënyrë?

12. Nga 12 fragmentet e zotërimit doktrinor që studiove në gjysmën e dytë të Librit të Mormonit, cili fragment i zotërimit doktrinor ka qenë veçanërisht i dobishëm ose domethënës për ty? Përse?
